



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

**PROGRAMI I LENDËS**  
**Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore**

**TITULLI I LËNDES: HISTORIA E SHQIPËRISË 1. LASHTËSIA**

**Pedagogu:** Prof. Dr. Lorenc Bejko  
**Ngarkesa:** 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)  
**Lloji i lëndës:** disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)  
**Programi i studimit:** Bachelor  
**Viti/Semestri:** I/I

**EKSTRAKT**

Historia e lashtë e Shqipërisë është e një nga lëndët themelore të ciklit të historisë së popullit shqiptar dhe ka për objekt kryesor studimin e ilirëve. Ajo trajton probleme të tilla të rëndësishme si gjurmët e hershme të shoqërisë njerëzore në trojet shqiptare dhe zhvillimi ekonomiko-shoqëror i grupeve prehistorike deri në shfaqjen e ilirëve. Një vend i veçantë i kushtohet në këtë cikël leksionesh diskutimit të procesit të etnogjenezës së ilirëve dhe problemeve që lidhen me shtrirjen gjeografike të tyre dhe topografinë e fiseve të ndryshme ilire. Trualli historik i ilirëve, jeta e tyre ekonomiko-shoqërore dhe kontakti i tyre me botën greke nëpërmjet kolonive helene në bregdetin e Adriatikut janë disa nga çështjet e tjera që do të trajtohen.

Një pjesë e madhe e orëve mësimore dhe diskutimeve në klasë do të kushtohet problemit të rëndësishëm të lindjes, karakterit dhe përmbajtjes së formacioneve shtetërore ilire. Organizimi politik i Mbretërisë ilire dhe dinastitë e ndryshme në krye të saj si dhe roli i organizimit shtetëror në zhvillimet ekonomike, politike, diplomatike e ushtarake të kohës do të diskutohen gjerësisht në pjesën e dytë të ciklit të leksioneve. Krahas formacionit shtetëror të ilirëve do të diskutohen edhe zhvillimet e ngjashme në Epir e Dardani së bashku me raportet e tyre me ilirët në disa nga momentet më të spikatura historike të shekujve 4 – 2 p.e.s.

Luftrat iliro-romake dhe evidentimi i shtetit ilir si një fuqi e rëndësishme mesdhetare do të trajtohen në pjesën e tretë të ciklit të leksioneve. Dinamizmi i ketyre ngjarjeve të rëndësishme dhe vendosja e mëpasme e territoreve të Ilirisë nën administrimin romak përbëjnë thelbin e diskutimeve të kësaj pjese të lëndës.

**TEMAT:**

**LEKSION 1.** Historia e studimeve dhe studiuesit e ilirëve.

**LEKSION 2.** Ilirët prehistorikë: gjurmët e hershme të shoqërisë njerëzore; epokat e gurit, bronzit dhe hekurit.

**LEKSION 3.** Origjina dhe trualli historik i ilirëve. Topografia e fiseve ilire.

**LEKSION 4.** Gjuha e ilirëve: ilirishtja dhe shqipja.

**LEKSION 5.** Ilirët dhe kolonitë helene të bregdetit ilir.

**LEKSION 6.** Jeta, vdekja, kultura, arti dhe botkuptimi i ilirëve në shekujt 10-5 p.e.s.

**LEKSION 7.** Lindja e jetës qytetare dhe Mbretëria e Parë Ilire: Dinastia e Bardhylit.

**LEKSION 8.** Mbretëria e Dytë Ilire: Dinastia e Glaukisë.

**LEKSION 9.** Shteti i Epirit.

**LEKSION 10.** Shteti ilir si fuqi mesdhetare: Lufta e Parë dhe e Dytë iliro-romake.

**LEKSION 11.** Lufta maqedone-romake dhe Lufta e Tretë iliro-romake.

**LEKSION 12.** Mbretëria e Dardanisë.

**LEKSION 13.** Iliria në Perandorinë Romake. *Pax Romana*.

**LEKSION 14.** Nga Ilirët tek Shqiptarët.

**LEKSION 15.** Trashëgimia ilire në Ballkan.

**FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT****FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

**KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

**DETYRA E KURSIT:**

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

*20 % e notës përfundimtare*

**KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

*40 % e notës përfundimtare*

**DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN**

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

**LITERATURA:**

1. *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*. Instituti Arkeologjik, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Botimet Toena, Tiranë 2002.

2. *Historia e Popullit Shqiptar. Vëllimi I: Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. 16–vitet 20 të shek. 20*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Botimet Toena, Tiranë, 2002. (Pjesa e parë. Ilirët: 19–192).

3. *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*. Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1969.

4. Selim Islami 2008 *Historia e Ilirëve*. Botimet Toena, Tiranë.

5. Hasan Ceka 1998 *Në kërkim të historisë ilire*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

6. Neritan Ceka 2001 *Ilirët*. Ilar, Tiranë.

7. Aleksandër Stipçeviq 2002 *Ilirët: historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*. Botimet Toena, Tiranë.

8. Wilkes, J. *The Illyrians*. Tiranë 2002.

9. P. Cabanes *Ilirët: nga Bardhyli tek Genti*. Carpediem, Tiranë 2003.